

# DEMOS

## BULETIN

Granti i Performancës  
Komunale 2020

## Komuna e Pejës me performancën më të mirë për vitin 2018

Granti i Performancës Komunale (GPK) u jep grante komunave bazuar në performancën e tyre në fushat e zgjedhura si një nxitje për të stimuluar komunitetet që të përmirësojnë më tej performancën e tyre.

GPK-ja stimulon performancën e përmirësuar në: qeverisjen demokratike, menaxhimin komunal dhe ofrimin e shërbimeve.

GPK-ja është një mekanizëm i krijuar dhe bashkëfinancuar nga Ministria e Pushtetit Lokal (MPL) dhe Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Suedia dhe Norvegjia, si dhe i zbatuar së bashku me projektin DEMOS të Bashkëpunimit Zviceran Helvetas.

Në baza vjetore, Ministria e Pushtetit Lokal (MPL) së bashku me donatorët e saj të GPK-së organizon ceremoninë për të shpallur dhe festuar suksesin e komunave me performancën më të mirën në treguesit e qeverisjes së mirë në kuadër të skemës GPK.

Gjatë ceremonisë, komunitetet zbulojnë rezultatet e tyre të performancës në qeverisjen demokratike, menaxhimin komunal dhe ofrimin e shërbimeve. Dhe më e rëndësishmja, ato shpërblehen në përputhje me performancën e tyre. Ato gjithashtu zbulojnë se cila komunitet do të jetë mbajtësi krenar i titullit “Komuna më e mirë”.

Situata emergjente e shëndetit publik në Kosovë për shkak të shpërthimit të COVID-19 ua pamundësoi Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe donatorëve

të saj kryesorë të organizojnë ceremoninë vjetore të ndarjes së çmimeve për grantet e performancës këtë vit.

Në vend të ceremonisë, MPL-ja dhe donatorët nxorën një deklaratë të përbashkët për shtyp me anë të së cilës njoftuan rezultatet e ciklit të GPK-së 2020. Për më tepër, u mbajtën edhe aktivitete të tjera mediale dhe online për ta shënuar këtë ngjarje të rëndësishme vjetore.

Vlerësimi i Performancës Komunale për grantin e vitit 2020 shpërbleu 23 komuna.

Risia e gantit të këtij viti ishte që tri komuna me performancën më të mirën morën grante shtesë për performancën e tyre:

Komuna e Pejës  
Vendi i parë

Komuna e Junikut Vendi  
i dytë

Komuna e Lipjanit  
Vendi i tretë

“Granti i performances komunale është shumë i rëndësishëm për mua si kryetar, por gjithashtu për të gjithë personelin e komunës sonë. Ky grant e vlerëson punën e bërë gjatë një viti dhe kontribuon në zhvillimin e mëtutjeshëm. Ne si komunë kemi alokuar resurse që të punojnë me përkushtim në ngritjen e performancës në të gjithë treguesit e GPK-së, e në veçanti në treguesit me performacë të ulët. Puna e bërë edhe u shpërblye me fonde shtesë, sepse fituam titullin “Komuna me performancë më të mirë”. S’fundja e gjitha bëhet me dhe për qytatarët tanë. Nëse komuna punon, qytetari fiton!”

**Gazmend Muhaxheri – Kryetar i Komunës së Pejës**



Gjithsej 4.9 milionë euro iu ndanë komunave të kualifikuara, si dhe çmime shtesë për tri komunat me performancën më të mirë në Kosovë.

Kur flasim për angazhimin dhe vendosmërinë për të përmirësuar performancën komunale, komuna e Pejës është një shembull i shkëlqyeshëm.

Në vlerësimin e vitit të kaluar për punën e GPK-së, Peja ishte e dyta, por vizioni i qartë i kryetarit të Pejës dhe puna e palodhur e stafit të tij ka dhënë rezultate të mëdha për këtë komunë.

Për ta arritur titullin “Komuna më e mirë”, kjo komunë bëri një hap tut-

je. Komuna e Pejës ndau burime shtesë dhe krijoi një grup punues i cili përqendrohet në përmirësimin e rezultateve në të gjithë treguesit e GPK-së dhe veçanërisht aty ku performanca ishte e ulët. Komuna organizoi punëtori të posaçme të brendshme për të identifikuar fushat që kanë nevojë për përmirësim, për të planifikuar veprimet përkatëse për përmirësim, si dhe monitoroi progresin rregullisht. Sipas kryetarit të Pejës, GPK-ja nuk vlerëson dhe shpërblen vetëm performancën vjetore të komunave, por gjithashtu kontribuon në zhvillimin e tyre të mëtejshëm.

Gatishmëria dhe udhëheqja e mirë komunale mund të sjellin një ndryshim pozitiv në një periudhë mjaft të shkurtër kohore. Kjo ishte shumë e qartë në diskutimet me komunat me performancën më të mirë, ku kryetarët e komunave, drejtorët dhe nëpunësit civilë janë shumë mirë të informuar se si funksionon GPK-ja, si maten treguesit, mundësitë për një fitim të shpejtë dhe cilët tregues kërkojnë më shumë energji dhe kohë për të arritur rezultate pozitive. Kjo qasje strategjike është shumë e qartë në komunën e Pejës, ku mund të shihet Kryetari i Komunës me plan të qartë dhe përkushtim për rritjen e qëndrueshme të performances.



Vendi i 1-rë “Komuna me performancën më të mirë” për Grantin e 2020-ës



## ROLI DOMINANT I ASOCIACIONIT TË KOMUNAVE NË MENAXHIMIN E PANDEMISË COVID – 19

Si çdo vit tjetër, edhe 2020 Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) e nisi më planet vjetore bazuar në Strategjinë katërvjeçare. Por, situatën e punëve dhe angazhimeve normale e të planifikuar në bazë të nevojave dhe kërkesave të Komunave, e zhvendosi shfaqja e pandemisë Covid 19, ku nxori edhe sfida dhe nevoja të reja të komunave të situatës për të cilat AKK-ja duhej lobuar dhe adresuar tek niveli qendror.

Pandemia Covid – 19 e shfaqur edhe zyrtarisht në Kosovë në mes të muajit mars ka shtyrë mekanizmat e Asociacionit të Komunave të Kosovës të punojnë në rrethana e kushte tjera por pa devijuar formën e lobimit dhe avokimit në mbrojtje dhe shtytje të interesave të Komunave të Kosovës.

Përmes platformave të ndryshme teknologjike Zyra e AKK-së ka qenë online pothuaj 24/7 në komunikim me komunat (nga struktura e Këshillit të Kryetarëve deri tek Ko-

legjiomet dhe resorët tjerë të zyrtarë komunalë) për të adresuar kërkesat dhe nevojat e tyre dhe në anën tjetër edhe për t'i informuar ato me zhvillimet nga qeveria e Kosovës ose anasjelltas. Vlen të ceket këtu bashkëpunimi i mirë me institucionet qendrore dhe vlerësimin të qartë të rolit tonë edhe në këtë kohë. Përfaqësuesi i AKK-së ka qenë anëtar i Grupit Menaxhues për Pandeminë në nivel vendi.

Si rezultat i këtij angazhimi dhe punës së AKK-së është arritur që në periudhën për më pak se dy muaj të adresohen qartë në nivelin qendror dhe të realizohen e kthehen në veprime qeveritare e lokale shumë çështje të ndryshme të komunave për nevoja të menaxhimit sa më të mirë të kësaj pandemie nëpër Ministri të ndryshme.



**Arsim Osmani**

Pra, vetëm në këtë periudhë dymujore, me kërkesat dhe lobimin Asociacionit të Komunave të Kosovës u realizuan këto veprime, ndër më kryesoret:

- 1 Qeveria vendosi që Komunave t'iu mundësohet bartja e mjeteve nga vija buxhetore për investime kapitale në një vijë buxhetore e cila do ti mbulojë nevojat dhe kërkesat që dalin vetëm nga Shtabet Komunale të Emergjencave në luftë për parandalimin e përhapjes së COVID 19.
- 2 Ndryshohet Urdhëresa "Për mbarëvajtjen e veprimtarisë ekonomike gjatë emergjencës së shërbimit publik" e datës 17.03.2020 nxjerrë nga Ministria e Ekonomisë, Punës, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike (MEPTINS).





- 3** Komisioni Rregullator i Prokurimit Publik ka nxjerr ‘njoftimin’ për lehtësimin e procedurave të publik për autoritetet, lehtësimin që iu mundësoi komunave që shërbimet të cilat ofroheshin nga komunat në luftë për parandalimin e përhapjes së COVID 19 të kontraktohen me anë të negocimit me operator ekonomik për shkak situatës emergjente.
- 4** Pezullohet mos-shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve të Kuvendeve të Komunave për aspektet financiare në parandalimin e Covid-19 nga ana e Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL).
- 5** Qeveria e Republikës së Kosovës ka ndryshuar orarin për ndalesën e qarkullimit të qytetarëve dhe automjeteve private.
- 6** Ministria e Financave dhe Transfereve ka aprovuar ndalesën e kamatave dhe ndëshkimeve për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës për vonesat në pagesën e Tatimit në pronë deri në kalimin e pandemisë.
- 7** Ministria e Shëndetësisë ka vendosur që orari i kufizimit të lëvizjes së qytetarëve do të mbetet i njëjtë për të gjitha komunat; nga ora 17.00-06.00, përveç komunës së Malishevës dhe Mitrovicës Veriore.
- 8** Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) krijoi mundësi pune për bujqit, që ishin në kulmin e punës së tyre në fushë dhe i’u mundësua të fillojnë me punën e tyre pa pengesa lëvizjeje.
- 9** Ministria e Ekonomisë, Punës, Tregtisë, Investimeve, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike lejon punimet e Komunave në investimet infrastruktore dhe të mirëmbajtjes së shërbimeve. Kjo u lejua me kusht që të merret një leje paraprake nga MEPTINS.




**10** Komunave iu mundësua që të shpallin tenderë dhe të vazhdojnë me aktivitete të prokurimit si tender si për furnizime, shërbime apo punë tjera në bazë të planeve që i kanë (planet e prokurimit).

**11** Fillon mos aplikimi i kamatë-vonesës dhe gjobës për tatimin e papaguar në kohë të këtij viti tatimor (2020), përgjatë gjithë vitit 2020. Pezullimi i aplikimit të llogaritjes së interesit (kamatës) dhe gjobës për mos pagesën e tatimit në pronën e paluajtshme vlen deri më 31 dhjetor 2020.

**12** Nis mbajtja e seancave të Kuvendeve të Komunave me kushte dhe masa të parapara nga institucionet relevante.

**13** Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike (MPBAP) ka shtyrë dhe pezulluar afatet e procedurës administrative për regjistrimin/deklarimin e fakteve të lindjeve dhe të vdekjeve të cilat kanë ndodhur nga data 13 shkurt 2020 deri në një vendim tjetër.

Poashtu, bazuar në punën dhe rezultatet, edhe në këtë kohë, AKK-ja ka qenë si asnjëherë tjetër e pranishme në publik duke ngritur imazhin e saj në mbrojtje të nevojave dhe kërkesave të pushtetit lokal. Është vlerësuar si institucion lider me aktivitete që ndihmonte menaxhimin e kësaj pandemie dhe organizata kryesore dhe e vetme në rolin ndërlidhës mes nivelit lokal dhe atij qendror.





## Takime virtuale me komunat gjatë kohës së pandemisë

Si reagim ndaj numrit në rritje të rasteve me COVID-19, jo vetëm në Kosovë por në të gjithë botën, pothuajse të gjitha institucionet, përfshirë qeveritë komunale, po detyrohen të ndryshojnë mënyrën e funksionimit të punës së përditshme të tyre.

Disa institucione, organizata po vazhdojnë me takime të rregullta drejtpërdrejtë me masa të distancimit social, ndërsa të tjerat po veprojnë pothuajse ekskluzivisht në internet.

Që nga ditët e para të situatës me pandemi, DEMOS ka reaguar në mënyra të ndryshme në mënyrë që të vazhdojë punën dhe të mos ndalë mbështetjen për komunat dhe ministritë e tjera përkatëse të cilat janë shumë domethënëse për projektin.


Përdorimi i teknologjive na ka ndihmuar të qëndrojmë më pranë komunave gjatë këtyre kohërave të vështira.

Përmes takimeve virtuale, ekipi i projektit DEMOS u takua me kryetarët e komunave, drejtorët, kryesuesit e kuvendit dhe përfaqësues të tjerë të rëndësishëm

të komunave për të diskutuar Grantin e Performancës Komunale (GPK) në përgjithësi, dhe performancën individuale të secilës komunë. Këto takime ishin mundësi e shkëlqyeshme për të parë më nga afër sfidat dhe mundësitë për përmirësimin e performancës në GPK, por edhe sfidat që iu paraqiten komunave si rezultat i pandemisë COVID-19.

Sfidat e tilla si vonesat në procedurat e prokurimit, nevoja për të kuptuar më mirë treguesit e rinj në GPK, nevoja për ngritjen e mëtejshëm të kapaciteteve në disa tregues të caktuar ishin pjesë e diskutimit të drejtpërdrejt virtual.

Për të përmendur një tregues të veçantë që konsiderohet si një nga treguesit më sfidues në arritjen e performancës së mirë nga shumica e komunave, është treguesi që mat pjesëmarrjen e grave në seancat publike komunale. Sipas komunave, arsyeja e pjesëmarrjes së ulët të grave në seancat dëgjimore është kombinimi i faktorëve të ndryshëm, siç janë normat sociale, mungesa e interesit të përgjithshëm të qytetarëve për pjesëmarrje, por edhe besimi i ndërsjellë i nevojshëm për vendimmarrje pjesëmarrëse.




Pandemia COVID-19 ka pasur pa dyshim efekt në performancën e komunave gjatë vitit 2020.

Sipas shumicës së komunave, ato nuk do të jenë në gjendje të përmbushin planet e tyre për investime kapitale si rezultat i kushteve të krijuara nga pandemia COVID-19. Kjo do të ketë ndikim të drejtpërdrejt në përmbushjen e kriterëve të kualifikimit të Grantit të Performancës Komunale, d.m.th që komunat duhet të arrijnë të paktën 75% të shpenzimeve buxhetore për investime kapitale, në mënyrë që të kualifikohen për grantin.

Për më tepër, gjatë takimeve tona virtuale u shqyrtuan disa ide të reja; ofrimi i trajnimeve në internet për zyrtarët komunalë si dhe mbështetja e ofruar komunave për të organizuar konsultime me qytetarët duke përdorur platforma në internet dhe në këtë mënyrë për të inkurajuar pjesëmarrjen e qytetarëve.

Ekipi i projektit DEMOS vazhdon të punojë nga afër me komunat dhe institucionet e tjera përkatëse në Kosovë si mbështetje e vazhdueshme drejt qeverisjes lokale më transparente, gjithëpërfshirëse dhe efikase.



## Integriteti: T'i bësh gjërat në mënyrë të duhur edhe kur askush nuk është duke të të shikuar

Qeverisja e mirë është një temë e debatueshme. Mënyra e menaxhimit të aktiviteteve dhe resurseve publike nga institucionet publike shkakton polemika dhe kritika. Kjo na shqetëson thellësisht. Pse? Sepse puna jonë kontribuon dhe prek shumë elemente të qeverisjes së mirë, të cilat përfshijnë transparencën, integritetin, politikat e shëndosha, pjesëmarrjen, llogaridhënien, përgjegjshmërinë dhe mospraninë e korrupsionit.

Institucionet publike në Kosovë përballen me rreziqe të korrupsionit që mund të kenë efekte negative në funksionimin e tyre dhe besimin e

publikut. Planet e Integritetit hartohen për t'iu ndihmuar institucioneve në adresimin sistematik të rreziqeve të identifikuar ndaj integritetit, me qëllim të fuqizimit të rezistencës institucionale ndaj korrupsionit dhe kështu zvogëlimin e niveleve të korrupsionit. Për këtë qëllim, para disa viteve UNDP, nëpërmjet projektit të financuar nga Agjencia Zvicrane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), së bashku me Agjencinë kundër Korrupsionit në Kosovë (AKK), ka punuar për hartimin e këtyre planeve për identifikimin e proceseve më të cënueshme nga korrupsioni në institucione të përgjegdhura dhe për të instaluar plan-

ifikimin e integritetit në punën e tyre të përditshme. Si rezultat, shumë komuna kanë hartuar planet e tyre të integritetit. Megjithatë, shumica e këtyre planeve kanë skaduar dhe duhet të përditësohen. Ministria e Pushtetit Lokal (MPL), si pjesë e planit të saj të veprimit, do të hartojë modelin e planit të integritetit, në mënyrë që komunat të mund ta përdorin atë model dhe t'i pasqyrojnë specifikat dhe kërkesat e tyre.


Si pjesë e Grantit të Performancës Komunale, projekti DEMOS matë në baza vjetore nëse komunat kanë dërguar te Kuvendet komunale raportin vjetor të zbatimit të Planit

Komunal të Integritetit, si një nga instrumentet e luftimit të korrupsionit brenda komunës.

Bazuar në të dhënat nga Sistemi për Menaxhimin e Performancës

Komunale, performanca mesatare komunave në këtë tregues është vetëm rreth 50%. Kjo nënkupton që Planet e Integritetit dhe zbatimi i tyre janë diskutuar në Kuvendet Komunale vetëm në 18 komuna. Lajmi

i mirë është që numri komunave që e kanë diskutuar zbatimin e Planit të tyre të Integritetit është rritur në mënyrë të konsiderueshme në vitin 2018 në krahasim me vitin 2016 dhe 2017.



Gjatë vitit 2019, Projekti DEMOS ka mbajtur disa trajnime me anëtarët e të gjitha Kuvendeve Komunale të Kosovës, ku planifikimi i integritetit ka qenë njëra nga temat. Në këtë trajnim ka marrë pjesë edhe Komuna e Hanit të Elezit. Drejtori i Administratës ka qenë shumë i interesuar për të kuptuar më mirë rëndësinë dhe përbajtjen e këtij plani. Falë gatishmërisë dhe angazhimit të tyre, Komuna e Hanit të Elezit ka arritur të hartojë Planin e Integritetit për herë të parë dhe më vonë është miratuar nga Kuvendi Komunal në fund të muajit dhjetor të vitit 2019.

Sipas Drejtorit të Administratës, Edon Curri, ky trajnim iu ka ndihmuar që të kuptojnë më mirë dhe të thjeshtësojnë zbatimin e organizimit të brendshëm të punës në administratën e tyre, si dhe t'i kuptojnë më mirë çështjet praktike të hartimit dhe

zbatimit të Planeve të Integritetit.

“Plani i Integritetit tregon angazhimin tonë për përmirësimin e mëtejshëm të kontrolleve ekzistuese operationale në aktivitetet e realizuara, duke përfshirë ofrimin e shërbimeve për qytetarët. Për këtë qëllim, ai specifikon masat e bazuara në rrezik për t'i përmbushur objektivat e tij për integritet dhe për të fuqizuar sundimin e ligjit dhe vlerat dhe standardet profesionale,” konstatoi z. Curri.

Efektet e pandemisë aktuale COVID-19 kanë pasur ndikim në zbatimin e këtij plani për Komunën e Hanit të Elezit. “Fatkeqësisht, pasi kemi aprovuar planin dhe kemi filluar punën për strategjinë e zbatimit, prioritetet tona komunale kanë kaluar në menaxhimin e situatës emergjente në shëndetësi të krijuar nga pandemia aktuale në komunën

tonë. Jemi duke bërë përpjekje për t'i kushtuar vëmendje integritetit, ku prokurimi i realizuar në këtë situatë të emergjencës i përmbush standardet që kërkohen me legjislacionin në fuqi dhe që mallrat dhe punimet e prokuruarra janë në të mirë të qytetarëve të synuar”, shpjegoi z. Curri. Shumica e komunave e konsiderojnë këtë si tregues shumë të rëndësishëm pasi që matet zbatimi i planeve të integritetit dhe tregohet gatishmëria dhe përpjekjet e komunave për t'i parandaluar praktikatat e korruptuara dhe për të zbatuar qeverisjen e mirë.

Ekzistojnë njohuri dhe praktika të mira për t'i bërë gjërat në mënyrë të duhur, vetëm duhet të tregojmë gatishmëri për reformimin e komunave për t'i bërë gjërat në mënyrë të duhur edhe kur askush nuk është duke na shikuar – Kjo nënkupton integritet!